

KONTRATË SHITBLERJE

(KUOTASH)

Sot më datë 20/05/2024 mes palëve të mëposhtme kontraktuese lidhet kjo kontratë shitblerje kuotash:

Shitësi: **Znj. Edlira Martiri**, shtetas shqiptare, lindur me 06.04.1980, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit nr. 033451000 dhe nr. personal I05406056F (referuar me poshtë si **Shitësi**).

Blerësit: **Znj. Gentjana Muça**, atësia Sefedin, shtetas shqiptar, lindur më 30.03.1993 lindur në Kostejë dhe banues në Lagjia e Re, nr. 31, Vorë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr. Personal J35330038N.

(referuar më poshtë si **Blerësit**)

Dispozita të përgjithshme

- A. Shoqëria “CYBER MORFOSIS” shpk, është person juridik, i regjistruar në Regjistrin Tregtar të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me Nr. NUIS M41525002N. Kapitali i shoqërisë “CYBER MORFOSIS” shpk është 10000.00 (dhjete mijë) Lekë, i perbere nga 1 (nje) kuot.
- B. Shitësi është ortak i vetem i Shoqërisë “CYBER MORFOSIS” shpk dhe zotëron 100 % (njqind përqind) të kuotave, dhe dëshiron t’ia shesë blerësit, kuotat e tij.
- C. Blerësit Znj. Gentjana Muça, dëshiron të blejë nga shitësi, kuotën me vlerën totale prej 50 % (pesedhjetë përqind), e cila do t’i blihet shitësit në mënyrën që do të përcaktohet më poshtë.

Në përputhje me nenin 73: “Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave” pika 1/b dhe pika 3 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare», i ndryshuar, neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, si dhe në Statutin të Shoqërisë “CYBER MORFOSIS” sh.p.k, Palët bien dakord sa më poshtë:

Neni 1 Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotës së Kapitalit të Shoqërisë prej 50% pesedhjetë përqind) që zotëron Shitësi në kapitalin themeltar të Shoqërisë (“Kuota”), në masën prej 50 % (pesedhjetë përqind) Znj. Gentjana Muça.
Kjo kuotë transferohet nga Shitësi në pronësi të Blerësit, sipas mënyrës së përcaktuar më sipër.

1.2 Blerësi e pranon pronësinë e totalit prej 50% (pesedhjetë përqind) të Kapitalit të Shoqërisë të perbere si më sipër.

Neni 2 Çmimi i Shitjes

- 2.1 Çmimi për blerjen e kuotës do të jetë në total i barabartë me 5,000 (pese mijë) lekë.
- 2.2 Palët deklarojnë se cmimi i shitjes është likujduar në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 2.3 Titulli i pronësisë mbi Kuotat do të transferohet nga Shitësi tek Blerësi në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 2.4 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi fiton të drejten e pronësisë mbi Kuotën përkatëse, ndërsa Shitësi zhvishet nga cdo e drejtë pronësie mbi Kuotën dhe të drejtat që rrjedhin prej saj.
- 2.5 Me nënshkrimin e kësaj kontrate blerësi autorizohet të kryejë procedurat e regjistrimit të këtij veprimi juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 3 Garancitë

- 3.1 Shitësi është pronar i ligjshëm i 100 % (njqind përqind) të kuotave në shoqërinë “CYBER MORFOSIS” sh.p.k, të cilat në total kalojnë në pronësi të blerësit.
- 3.2 Shitësi garanton Blerësin që 50 % (pesedhjetë përqind) e kuotave të transferuara në total, janë krejtësisht të lira dhe nuk janë vendosur si mjet ligjor për të siguruar ekzekutimin e ndonjë detyrimi.
- 3.3 Palet deklarojnë dhe garantojnë se duke lidhur dhe zbatuar këtë Kontrate nuk vijnë në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore, kontraktuale apo statutore, kur është e zbatueshme.
- 3.4 Palet deklarojnë se pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe kalimit të pronësisë nga shitësi tek blerësi, shitësi clirohet nga cdo detyrim i mëparshëm, aktual dhe i ardhshëm ndaj shoqërisë “CYBER MORFOSIS” shpk dhe palëve të treta deri ne masen e kuotes se tij.

Neni 4 Regjistrimi

- 4.1 Regjistrimi i transferimit të kuotave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) kryhet në bazë të nenit 74 të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 « Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare » si dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
- 4.2 **Pas regjistrimit të kësaj kontrate shitje shoqëria “CYBER MORFOSIS” shpk do të ketë dy ortak dhe konkretisht:**

Znj. Edlira Martiri zotërues i një kuote që përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë.

Znj. Gentjana Muça zotërues i një kuote që përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë

Neni 5
Ligji i zbatueshëm

- 5.1. Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë”, Ligji “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe Statuti i Shoqërisë “CYBER MORFOSIS” sh.p.k.

Neni 6
Juridiksioni

- 6.1. Për çdo mosmarrëveshje lindur mes Palëve lidhur me interpretimin, zbatimin e kontratës e cila nuk arrihet të zgjidhet me mirëkuptim mes tyre, juridiksioni kompetent do të jetë ai i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Neni 7
Dispozita të fundit

- 7.1 Nenet e përgjithshme janë pjesë e pandarë e kësaj kontrate.
7.2 Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët.
7.3 Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me pëlqimin e të dyja palëve, duke respektuar formën shkresore.

Kjo kontrate u përpilua në 3 (tre) kopje me vlerë të barabartë ligjore.. Palët deklarojnë se njohin dhe kuptojnë të gjithë përmbajtjen e kësaj kontrate. Kontrata u pranua nga palët dhe u gjend sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të shprehur. Ajo u nënshkrua në mënyrë të rregullt, nga palët.

SHITËSI
EDLIRA MARTIRI


BLERËSIT
GENTJANA MUCA
